



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:099654
Datë: 20.08.2024
Numri i dokumentit: 06064658

PPP.nr.399/23

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren individuale Erolinda Uka-Sadiku, duke vendosur në lëndën e përmbarimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) SH.A me seli në rrugën “ Nëna Terezë nr.36 Prishtinë, kundër debitorit N.H. (tani e ndjerë) ish nga M.” U.K.” me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur me prapësimin ndaj urdhrit përmbarimor P.nr.1070/19 të datës 25.06.2019, jashtë seancës me datën 20.08.2024 mori këtë

A K T V E N D I M

I.NDËRPRITET procedura përmbarimore në lëndën PPP.nr.399/23, e kreditorit K.E.K (KEK) SH.A me seli në rrugën “ Nëna Terezë nr.36 Prishtinë.

II.Procedura në këtë çështje përmbarimore do të vazhdojë pasi të identifikohen të gjithë trashëgimtarët e të ndjerës N.H dhe kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore do ta marrë përsipër vazhdimin e procedurës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktvendimin PPP.nr.678/2019 të datës 10.02.2021 ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit N.H me adresë në rrugën “ U.K, Mitrovicë të ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.1079/19 të datës 25.06.2019 sipas propozimit të kreditorit KEK Sha RR. “ Nëna Terezë” nr.36 Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë G.H i cili është paraqitur si i biri i të ndjerës- debitores për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave ligjore.

Gjykata e Apelit me Aktvendimin AC.nr. 3750/22 të datës 17.10.2023, ka aprovuar si të bazuar ankesën, ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë PPP.nr.678/19 të datës 10.02.2021 dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kreditori ka bërë propozimin për përmbarrim P.nr.2214/19 me datën 25.06.2019 në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit nga librat afaristë të lëshuar nga kreditori lidhur me borxhin për konsumimin e energjisë eklektike në shumë prej 5,598.13 euro.

Nga leximi i certifikatës së vdekjes me numër serik V 10175577, nr. të referencës 11/2008RV/11001, nr. rendor 59, rezulton se N.H me numër personal ka lindur me datën ndërsa ka vdekur me datën

Ndërsa kreditori propozimin për përmbarrim e ka paraqitur me datën 25.06.2019, një vit e katër muaj e njëzet e gjashtë ditë pas vdekjes së N.H.

Ligji për Procedurën Përmbarrimore në nenin 17 ka përcaktuar se Në procedurën përmbarrimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër.

Ligji për Procedurën Përmbarrimore në nenin 73.1 ka përcaktuar se “73.1 Palë në procedurë mund të jetë çdo person fizik dhe juridik” sipas kësaj dispozite personi fizik e fiton aftësinë juridike për të qenë palë në procedurë me lindjen e tij ndërsa përfundon me vdekjen e tij pra kusht që personi fizik të jetë palë në një procedurë gjyqësore është që i njëjti t jetë gjallë, që të ketë legjitimitet në këtë rast pasiv në këtë çështje civilo-juridike.

Ligji për Procedurën Kontestimore, në nenin 278 par.1 të LPK-së ka përcaktuar se “gjykata e ndërpret gjykimin po qe se ka vendosur që vetë të mos e zgjidhë çështjen paraprake”.

Gjykata vlerëson se për tu zhvilluar kjo çështje përmbarrimore, fillimisht duhet të zhvillohet procedura trashëgimore në mes trashëgimlënësve të ndjerës N.H..

Gjykata ka vlerësuar edhe dispozitat e nenit 35 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore lidhur me ndërprerjen e procedurës, mirëpo ka vlerësuar se nuk mund të aplikohen në këtë çështje civilo juridike sepse propozimi për përmbarrim është paraqitur ndaj personit të vdekur.

Ligji për Procedurën Përmbarrimore në nenin 38 ka përcaktuar se “1. *Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarrimi, kërkuesi i përmbarrimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarrimi, objekti i përmbarrimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit*”.

Tutje Ligji për Procedurën Përmbarrimore në nenin 35.4 ka përcaktuar se “4. Në rast të vdekjes së debitorit që nuk ka përfaqësues ligjor apo me prokurë, Gjykata, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita në të cilën është njoftuar për vdekjen e debitorit, emëron përfaqësuesin e përkohshëm në emër të trashëguesve të debitorit në ngarkim të shpenzimeve të kreditorit, si rregull nga radha e personave që e kanë në posedim pasurinë që është objekt

përmbartimi, dhe vazhdon procedurën. *Gjykata e emëron përfaqësuesin e përkohshëm brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, nga dita e parashtrimit të kërkesës. Po qe se personat e autorizuar nuk e propozojnë vazhdimin e procedurës brenda afatit që u është caktuar, Gjykata e pezullon procedurën përmbartimore. Gjykata mund të emërojë vetëm një person që nuk ka interes personal në konflikt me interesat e debitorit, dhe përfaqësuesi i përkohshëm ka për detyrë që të veprojë në interes të debitorit. Personi i emëruar ka të drejtën që të refuzojë emërimin, dhe Gjykata në atë rast ka të drejtën që të emërojë një zëvendësues”*

Me këtë dispozitë është rregulluar çështja kur debitori vdes sa është në zhvillim e sipër procedura përmbartimore e jo kur procedura përmbartimore fillohet dhe zhvillohet ndaj një personi të vdekur që nuk mund ta ketë cilësinë e palës së debitorit.

Duke qenë se Ligji për Procedurën Përmbartimore, nuk ka paraparë dhe rregulluar çështjen se si duhet vepruar në rastet kur procedura përmbartimore fillohet ndaj një personi i cili ka ndërruar jetë para fillimit të procedurës përmbartimore, e duke i marrë parasysh rrethanat specifike të rastit gjykata vlerëson se në këtë çështje për ndërprerjen e procedurës vijnë në shprehje dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore lidhur me ndërprerjen e procedurës, deri sa të identifikohen të gjithë trashëgimtarët e të ndjerës N.H.

Duke qenë se rrethanat e rastit përbëjnë shkaqe për ndërprerjen e procedurës, gjykata nuk u lëshua në shqyrtimin e prapësimit.

Nga të cekuat si më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të aktvendimit në mbështetje të neneve 17 dhe 35 të LPP-së lidhur me nenin 71.3 dhe 278, 280 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
2022:099654, 06.06.2022

G j y q t a r j a

Erolinda Uka-Sadiku

Udhëzim mbi mjetin juridik: Ndaj këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.